



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:065328

Datë: 10.03.2025

Numri i dokumentit: 06964177

Ac.nr.5555/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Faton Ademi kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Besnik Bislimaj anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Fiton Haklaj në procedurën jokontestimore, sipas propozimit të propozuesit J.Z nga Tirana, përfaqësuar sipas autorizimit nga T.ZH, avokate në Prishtinë, në lidhje me pranimin dhe njohjen e vendimit të huaj me numër të lëndës 9603AKTI, të datës 23.11.2018, duke vendosur në lidhje me ankesën e të autorizuarës së propozuesit, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, CN.nr.102/2021 i datës 10.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.03.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e propozuesit J.Z nga Tirana, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm CN.nr.102/2021 i datës 10.08.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar, CN.nr.102/2021, i datës 10.08.2023, ka vendosur si në vijim:

“ HEDHET poshtë propozimi i propozuesit J.Z nga Tirana, për pranimin dhe njohjen e vendimit me numër 9603AKTI, të datës 23.11.2018, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë – Republika e Shqipërisë.”

Kundër këtij aktvendimi ka paraqitur ankesë propozuesi përmes të autorizuarës së tij për shkak të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

-Ankesa e propozuesit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës, vërtetohet se Propozuesi J.Z nga Tirana, në këtë gjykatë me datë 15.11.2019, ka parashtruar propozim për njohjen e vendimit të Gjykatës së huaj, përkatësisht të vendimit me numër 9603AKTI, të datës 23.11.2018, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë – Republika e Shqipërisë, me të cilin është vendosur për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për zbatimin e deklaratës noteriale Nr. 4771 rep dhe nr. 1138/3 kol, e datës 27.11.2017, me kreditor J.Z dhe debitorë Aram Aksel Findikliyan, për pengimin e detyrave (principali) në shumë prej 6,660 €, me kamat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit të propozueses me aktvendimin CN.nr.459/2019, të datës 29.01.2020, ka refuzuar kërkesën e propozuesit J.Z për pranimin dhe njohjen e urdhrit të ekzekutimit për Titullin ekzekutiv deklaratën noteriale me numër 4771 rep dhe nr. 1138/3 kol, e datës 27.11.2017, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë – Republika e Shqipërisë, të datës 23.11.2018. Kundër këtij aktvendimi propozuesi përmes të autorizuarës së tij, me datë 20.02.2020, ka ushtruar ankesë për Gjykatën e Apelit, me propozim që vendimi i atakuar të abrogohet ose të ndryshohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, më Aktvendimin Ac.nr.1219/20, të datës 08.03.2021, ka aprovuar si të bazuar ankesën e propozuesit J.Z nga Tirana, duke vendosur të prishet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, CN.nr. 459/2019, i datës 29.01.2020, dhe lënda t'i kthehet të njëjtës në rigjykimin dhe rivendosje. Duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktvendimit të atakuar, nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore, të cilat i referohen procedurës jo kontestimore, si dhe dispozitave të nenit 102.1 të LPK-së, ku parashihet se “*Kur një parashtresë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtresën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtresës*”, mbi këtë bazë gjykata e shkallës së parë është dashur të kërkoj nga propozuesi, që ta plotësoj propozimin për njohjen e vendimit të huaj, duke përfshirë informacione dhe dokumente përkatëse për origjinalitetin e vendimit, plotfuqishmërinë dhe përmbarushmërinë e tij.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas sugjerimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me aktvendimin CN.nr.102/2021, të datës 26.04.2021, i'a kthehen në plotësim propozimin propozuesit J.Z që në afat prej 3 ditësh ta plotësoj propozimin me Vendimin e huaj gjyqësor, i cili duhet të ketë vërtetimin e gjykatës së huaj kompetente mbi formën e prerë të këtij vendimi, sipas të drejtës së shtetit në të cilin është marrë si dhe Deklaratën noteriale numër 4771 rep dhe numër 1138/3 kol, datë 27.11.2017, e lidhur pran noterës M.XH, si dhe adresën e saktë të kundër propozuesit Aram Aksel Finidikiliyan. Në pikën II të dispozitivit të aktvendimit në fjalë, është paralajmëruar propozuesi se do të konsiderohet se është tërhequr propozimi po që se nuk i

kthehet gjykatës brenda afatit ligjorë, e në qoftë së kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, do të hedhet poshtë propozimi.

Propozuesi përmes të autorizuarës së tij me datë 14.05.2021, në gjykatë e ka dorëzuar një parashtrësë të cilës i'a ka bashkangjitur Vendimin për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit i datës 23.11.2018, i Gjykatës së Rrethit të Tiranës, Deklaratën noteriale me nr.4771rep dhe nr.1138/3 kol, e datës 27.11.2017, e lidhur para noterës M.XH, si dhe adresa e Aram Aksel Findikilyan. Mirëpo propozuesi nuk ka vepruar sipas Aktvendimit të gjykatës, ashtu që vendimi me numër 9603AKTI, i datës 23.11.2018, nuk përmban klauzolën se i njëjti vendim është i plotfuqishëm, ashtu siç ka theksuar edhe gjykata e Apelit, e po ashtu në vendimin me numër 9603AKTI, të datës 23.11.2018, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë – Republika e Shqipërisë, është cekur emri edhe i një kreditorit tjetër A.S, i cili nuk është palë në këtë procedure.

Me nenin 99, paragrafi 2, të LPK-ës është përcaktuar se *“Parashtrësat duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet për të vepruar sipas tyre. Ato duhet të përmbajnë sidomos: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin (emërtimin e personit juridik), vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjorë apo me prokurë, nëse i kanë, objektin e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe firmën e parashtruesit”*. Kurse me nenin 102, paragrafi 1 dhe 3, është përcaktuar se *“Kur një parashtrësë nuk është e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2. të nenit 99, gjykata do ta kërkojë nga dërguesi që ta korrigjojë ose ta plotësojë. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për kryerjen e korrigjimeve dhe plotësimeve duke i caktuar një afat prej 3 (tre) ditësh për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës. Parashtrësja do të konsiderohet e tërhequr nëse nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar në sipas paragrafit 1. të këtij neni e nëse i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, e njëjta do të hidhet poshtë”*.

Gjykata, bazuar në theksimet si më lartë, konstaton se propozuesi nuk ka vepruar sipas aktvendimit me numër CN.nr.102/2021, të datës 26.04.2021, pasi që nuk e ka plotësuar të njëjtin sipas udhëzimeve të dhëna nga gjykata.

Andaj, gjykata vlerëson se në rastin konkret propozuesi nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme në drejtim të eliminimit të pengesave procedurale, duke u bazuar në nenin 3 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore, si dhe nenit 99, 102 dhe 253, lidhur me nenin 391, pika g) të LPK-së, e ka hedhur poshtë propozimin e propozuesit dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës jokontestimore e as të dispozitave të procedurës nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, për të cilat Gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, dhe rrjedhimisht edhe drejta materiale është zbatuar drejtë.

Fillimisht për të qartësuar gjykata e shkallës së parë nuk ka vendos në mënyrë meritore në raport me këtë qështje por në mënyrë procedurale, duke iu referuar faktit se me rastin e dorëzimit të

aktvendimit për përmirësim/plotësim të parashtresës propozuesi nuk ka vepruar konform kërkesave të gjykatës andaj gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se mosveprimi konform kërkesave me ratsine kthimit të propozimit për tia bashkangjit dokumentet sikurse është kërkuar është bazë që propozimit të hedhet poshtë.

Nuk qëndron pretendimi ankimor i propozuesit se ka paqartësi në vendimmarje se dispozitivi është i pa qartë sepse sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi është i qartë, është në përputhje me arsyetimin për mënyrën e vendimarrjes pra është arsyetuar fakti se parashtresa për plotësim të propozimit nuk i përmban plotësimin e kërkesave të kërkuara nga gjykata.

Në rastin konkret nuk vlerësohet interesi i palës propozuese sepse nuk është kontestues që secila palë që ka interes dhe që plotëson kërkesat sipas procedurës duhet të realizoj të drejtën e tij. Adresimi i palës propozuese se çfarë është dashur që të bëjë gjykata është e drejtë e palës të kërkoj ndërsa çfarë duhet bërë gjykata është çështje tjetër sepse gjykata në Kosovë vendosin në bazë të Ligjit dhe Kushtetutës.

Në procedurën e njohjes së secilit vendim të huaj gjykata ekzaminon dokumentin i cili kërkohet të njihet se është i përshtatshëm dhe në përputhje me legjislacionin tonë dhe nëse është në kundërshtim me titujt tonë të përmbartimit atëherë gjykatë kërkon ose plotësimin e elementeve tjera ose e refuzon. Në rastin konkret dokumenti i kërkuar për tu njohur nuk ka qenë i plotë për tu njohur nga gjykatat tona sepse i kanë munguar disa aspekte që për dikën mund të quhen teknike dhe formale por ashtu i kërkon Ligji i Procedurës Përmbartimore pra ka pasur mungesa formale e të cilat nga gjykata është kërkuar që të mënjanohej dhe meqenëse nuk janë mënjeluar propozimi është hedhur poshtë.

Gjykata në raport me vendimmarjen ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrë e të vendosurit sepse siç u cek më lart ky është vendim procedural dhe këtu ipen arsye për plotësimin apo jo të kushteve për tu marrur ky vendim andaj edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykatës së shkallës së parë i janë plotësuar kushtet për hüdhen e propozimit.

Mbi këtë gjendje faktike të konstatuar rezulton se edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë me referencë në dispozitat e cituara në aktvendimin e atakuar si neni 99, 100 dhe 102 par 3 të LPK-së.

Janë vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore, por të njëjtat nuk janë konsideruar të rëndësishme për të vendosur ndryshe.

Neni 3 i Ligjit Për Procedurën Jo Kontestimore përcakton se *“Në procedurën jokontestimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore, po që se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe”*.

Neni 101.1 i LPK-së përcakton se *“ Dokumentet që i bashkëngjiten parashtresës dorëzohen në origjinal, të përshkruara apo të fotokopjuara ”*

Neni 102, pika 1,2, dhe 3 të LPK-së përcaktojnë se “102.1 Kur një parashtresë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtresën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtresës. 102.2 Në qoftë se parashtrësja e lidhur me afat korrigjohet, gjegjësisht plotësohet dhe i dorëzohet gjykatës brenda afatit të caktuar për një gjë të tillë, do të konsiderohet se i është parashtruar gjykatës në ditën kur është paraqitur për të parën herë. 102.3 Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hidhet poshtë”

Nga interpretimi këtyre dispozitave ligjore, Gjkata e Apelit vlerëson, se meqenëse propozuesi nuk ka vepruar konform kërkesave të Gjykatës për dorëzim të vendimit i cili kërkohet të përmbahet me klauzolë se i njëjti është i plotfuqishëm, atëherë gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka hedhur poshtë propozimin e propozuesit, dhe këtë vendim e përkrahë edhe Gjykata e Apelit si të ligjshëm.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 209 pika b) e LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5555/2022, me datë 06.03.2025

Kryetari i Kolegjit - Gjyqtari
Faton Ademi d.v